



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH  
KESHILLI BASHKIAK BELSH**

Belsh më 15/ 04/ 2026

**PROCES – VERBAL**

**“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 15.04.2026”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

**Janë prezent në mbledhje 16 këshilltarë:**

1. Kujtim Dervishi
2. Erion Gjoshi
3. Avni Shtylla
4. Nexhip Elezi
5. Bujar Blloku
6. Erjon Qafa
7. Naime Ibrahimimi
8. Asqeri Kuqja
9. Gezim Gjoshi
10. Nertila Uruçi
11. Libeta Kotorri
12. Gazeli Hysa
13. Ismail Paja
14. Sami Uruçi
15. Enkeleda Kullolli
16. Aleksander Idrizi

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen. Hidhet në votim rendi ditës dhe miratohet me 14 vota pro dhe 1 Kunder.
- Hidhet në votim proces verbali dhe miratohet me 13 vota pro dhe 2 abstenim.
- Diskutohet pika nr.2 e rendit të ditës për miratimin e 6%. Mbron Entela Dervishi Projekt Vendimin.
- Nertila U: Punonjësja e ndihmës ekonomike duhet të vijë dhe të përgjigjet pranë këshillit.
- Gazeli H: Kërkojmë administratorin e Fierzës.
- Hidhet në votim pika nr.1 dhe miratohet me 15 vota pro.
- Diskutohet pika nr.2 e rendit të ditës për hapjen e shëtitores rreth liqenit të Merhojës.
- Nertila U: Duhet të kemi një projekt me kufijtë e pronës.

- Ndriçim Reka: Në fillim miratohet hapja e rrugës ,pastaj bëhet projekti. Ky vendim i hap rrugë projektit.
- Erion Gj: Ne miratojmë në parim,projekti është fazë tjetër.
- Ismail P: Ka ndonjë hartë kadastrale për hapjen e rrugës?
- Kujtim D:Sa është distanca nga bregu?
- Ndriçim R: Dy metra nga bregu i liqenit do të bëhet shëtitore për këmbësorët.
- Kujtim D: Duam planvendosjen e liqenit ,distanca dhe sa larg është prona.
- Hidhet në votim propozimi i kryetarit të këshillit dhe miratohet që projekt vendimi të vijë më i plotë herën tjetër.
- Sami U: A është projekti gati për rrugën ngjitur me kanalin furnizues?
- Ndriçim R: Po,projekti është në procedurë për tu zhvilluar dhe pritet lidhja e kontratës.
- Kalojmë te pika nr.3 e rendit të ditës për miratimin e vlerës financiare për rënien e zjarrit për z.Hyqmet Çarçiu.
- Mbron Ndriçim Qose: Po e miratojmë përsëri spese prefektura ka kërkuar ndryshime në studimin e tregut.
- Hidhet në votim pika nr.3 dhe miratohet me 14 vota pro dhe 2 kundër.
- Hidhet në votim pika nr.4 dhe miratohet me 14 vota pro dhe 2 kundër.
- Diskutohet pika nr.5 “Për miratimin e grupit të punës për PBA 2027-2029”
- Hidhet në votim pika nr.5 dhe miratohet me 14 vota pro dhe 1 kundër dhe 1 abstenim.
- Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës, “Projekt Vendim për miratimin e nivelit të pagës së punonjësve për vitin 2026”
- Nertila U: Kërkojmë një listë të punonjësve me pozicione.
- Hidhet në votim pika nr.6 dhe miratohet me 16 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.7 e rendit të ditës “ Për miratimin e tavaneve të të ardhurave dhe shpenzimeve për projekt buxhetin 2027 – 2029.
- Mbron P/Vendimin sekretari i përgjithshëm Alban Nipolli.
- Kujtim D: A ka planifikim për rritjen e taksave?
- Alban N: Planifikimi është bërë pa parashikuar rritjen e taksave dhe bëhet mbi bazën e vitit aktual.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro,2 vota abstenim pika nr.7 e rendit të ditës.
- Kalojmë te pika nr.8 për miratimin e shtesës së buxhetit për vitin 2026.
- Mbron P/vendimin Alban Nipolli dhe bën prezantimin për këshilltarët.
- Nertila U:Konkretisht për çfarë bëhet fjalë dhe për çfarë janë parashikuar këto fonde të donatorit.
- Alban N: Nuk do të ketë shtesë nga fondet e Bashkisë.
- Erion Gj: A do të vazhdojë ky projekt me Climax apo konkludon këtë vit?
- Alban N: Është përpilim i një dokumenti që na ndihmon në qasjen ndaj Turizmit që ka Bashkia Belsh.
- Hidhet në votim pika nr.8 dhe miratohet me 14 vota pro.
- Diskutohet pika nr 9, Për fshirjen dhe shuarjen e detyrimeve tatimore ndaj administratës vendore Belsh.
- Mbron P/Vendimin Ditjon Pepa dhe shpejgon që ky projekt është sjellë mbi bazën e ligjit të miratuar në vitin 2025.
- Nertila U: Vendosni një shpallje për të njoftuar qytetarët.

- Alban N: Ky është ligj dhe normalisht qytetarët janë të informuar nëpërmjet mediave dhe rrjeteve sociale.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.10 shtesë në rendin e ditës. Mbron Alban N. p/vendimin për një ndryshim në buxhet.
- Hidhet në votim pika nr.10 dhe miratohet me 12 vota pro dhe 1 kundër dhe 1 abstenim.
- Diskuton Ndriçim Reka për pikën nr.2 të për shëtitoren e Merhojës.
- Hidhet në votim (ri-hidhet) pika nr.2 e rendit të ditës dhe miratohet me 14 vota pro.
- Nertila U: Kërkoj lejen mjedisore për vënd depozitimin e mbetjeve.
- Në mbledhje merr pjesë qytetari Gëzim Muça dhe prezanton një shqetësim për hapje rruge në fshatin Dushk.
- Nërtila U: Nëse ka konflikt atëherë zgjidhja bëhet në gjykatë.
- Gazeli H: Kërkoj që të ndryshohet mënyra e parkimit në qytet ,ti drejtohem urbanistikës ta sistemojë sepse vështirëson lëvizjen e mjeteve.

**Mbyllet mbledhja me 10 vendime të miratuara.**

**Përgatiti :**  
**SEKRETARI I KËSHILLIT**  
**Endri REPA**